



ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA DIGJITALE OSE E-DEMOKRACIA?



Përdorimi i mekanizmave të demokracisë digjitale shërben:

- Për të rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve, duke nxitur llogaridhënien, transparencën dhe përgjegjshmërinë e organeve lokale;
- Për të përmirësuar efikasitetin e institucioneve publike
- Për të arritur një numër të madh njerëzish apo aktorësh të tjerë të komunitetit;
- Për të lehtësuar ndërveprimin dhe pjesëmarrjen elektronike të qytetarëve në procese të ndryshme.

Me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, janë krijuar një sërë mekanizmash digjital që po përdoren përherë e më tepër nga qeverisja vendore dhe aktorë të tjerë, si pjesë e demokracisë digjitale dhe shërbimeve që ofrohen përmes saj.

Angazhimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje janë tiparet kryesore të një shoqërie demokratike. Digjitalizimi i shpejtë dhe transformimi i shoqërisë gjatë viteve të fundit ka forcuar ndjeshëm fenomenin e pjesëmarrjes qytetare në hapësirën elektronike.

Pjesëmarrja elektronike nënkupton përdorimin e mjeteve elektronike, duke përfshirë internetin, faqet e mediave sociale dhe platforma të ndryshme për të rritur angazhimin dhe pjesëmarrjen tuaj në aktivitetet, programet, vendimmarrjen dhe shërbimet lokale.

Demokracia digjitale përfshin përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në mbështetje të proceseve demokratike, me në qendër qytetarin.

Ndër platformat e demokracisë digjitale mund të përmendim:

- **Faqet web të bashkive** të cilat synojnë të ofrojnë informacion për qytetarët mbi organizimin, veprimtarinë e njësisë vendore, shërbimet publike etj.
- Platforma Kombëtare **vendime.al**, e cila i shërben qytetarëve dhe subjekteve të interesuara të njihen me vendimet e këshillave bashkiakë të 61 bashkive të vendit në mënyrë të shpejtë, në çdo kohë dhe pa pagesë.
- **Platforma Open data**, që ofron të dhëna mbi indikatorët ekonomiko-shoqërorë në Shqipëri, të cilat i shërbejnë transparencës dhe kontrollit të aktiviteteve të ndryshme publike.
- **Platforma QytetariIN**, e cila synon fuqizimin e qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit për të luajtur një rol aktiv në përcaktimin e përparësive zhvillimore të komunitetit dhe territorit ku ato banojnë apo punojnë duke ndërmarrë peticione dhe iniciativa elektronike.

Kur flasim për demokracinë digjitale kemi parasysh:

- Përdorimi i teknologjive të votimit elektronik si shprehje e demokracisë pjesëmarrëse, psh. Nënshkrimi i peticioneve në mënyrë elektronike, pa patur nevojë të paraqiteni fizikisht;
- Përdorimi i teknikave online për të treguar opinionin publik (si p.sh. nëpërmjet plotësimit të anketave / pyetësorëve të ndryshëm dhe sondazheve në internet, duke shprehur kështu mendimin tuaj për një çështje të caktuar);
- Ndërtimi i komuniteteve online, në ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për përmirësimin e komunitetit tuaj dhe adresimin e çështjeve të përbashkëta;
- Përdorimi i hapësirave të diskutimit në faqet online (website) për të stimuluar diskutimin dhe debatin publik online, e cila ju mundëson të zhvillonit diskutime dhe komunikime me aktorë të ndryshëm si, përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore, organizata të shoqërisë civile, pjestarë të tjerë të komunitetit etj.

- Dhe një sërë platformash të tjera si: Stop Korrupsioni, Pyesni Shtetin, Përmirëso Qytetin, aplikacioni celular Tirana Ime, mediat sociale të bashkive etj.



Mbi mënyrën e aksesimit dhe përdorimit në mënyrë efektive të këtyre platformave, ju ftojme të **klikoni këtu** për të ndjekur videon mbi demokracinë digjitale.